



Home > Kryesoret

Atentati në Vlorë, shoqërohen 7 persona, sekuestrohen kamerat e sigurisë

06/03/2022 09:45



Shperndaj ne Facebook Shperndaj ne Twitter

Një atentat u krye mbëmbjen e kaluar ndaj Romeo Meçajt pranë stadiumit të qytetit. Mësohet se gjatë natës janë shoqëruar 7 persona që dyshohet se mund të kenë dijeni për ngjarjen e cila la të plagosur rëndë 33-vjeçarin, i cili u qëllua 15 herë me armë. Policia ka bërë të mundur sekuestrimin e kamerave të sigurisë në një lokal pranë vendngjarjes, aty ku u gjetën dhe 12 gëzhoja.

Romeo Meçaj u qëllua me breshëri kallashnikovi brenda mjetit të tij tip “Land Rover” rreth orës 21:00 të mbrëmjes. Ai po parkonte mjetin e tij, kur disa persona i janë afruar dhe e kanë qëlluar me armë zjarri, pasi e kanë pritur “shënjestrën” e tyre pranë stadiumit, ndërsa duket se kanë pasur dijeni të lëvizjeve të tij.

Pas të shtënave autorët u larguan me shpejtësi, ndërsa dogjën automjetin e tyre në zonën e quajtur “Shtatë Pallatet”, pranë Ujit të Ftohtë. Sipas Policisë së Shtetit, makina rezultoi me targa të vjedhura, ndërsa brenda saj janë gjetur dy kallashnikovë të djegur, të cilët dyshohet se u përdorën për të qëlluar në drejtim të 33-vjeçarit Meçaj i cili ndodhet i shtruar në spitalin e Traumës në Tiranë në gjendje të rëndë për jetën.

I riu rezultoi të jetë pronar i një lokali në zonën e Lungomares në Vlorë. Policia ka nisur hetimet dhe po punon për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

/a.r

LEXONI EDHE

Help To Defend Ukraine. Here Is The Country's Main Account

Ukraine's Major Charity To Donate To

Save Ukrainian Families. Every \$1 Matters

47 vjeçarja me fytyrë bebi. Ja çfarë bën ajo para gjumit

Kërpudhat toenail do të zhduket nëse ju bëni këtë!

47 vjeçarja me fytyrë bebi, ja sekretin e saj

Leave a Reply

Comment *

Name

POST COMMENT

